

Statuti dhe akti i themelimit

I shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar

DAG Construction sh.p.k

Forma e Shoqërisë

Neni 1

Sot, me 07.12.2023 themeluesit Darien Xhindoli dhe Glon Bakalli kanë krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **DAG Construction sh.p.k**. Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut, Akti I Themelimit dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Akti I themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo ceshtje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Themelues I shoqërisë është :

1. Darien Xhindoli ,shtetas shqiptar , i datelindjes 20.07.1979, lindur në Lushnjë,,madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, indentifikuar me nr letërnjoftim : 033367435 dhe me numer personal ID H90720230J.

2- Glon Bakalli ,shtetas shqiptar , i datelindjes 10.08.1977, lindur në Tiranë ,madhor me zotësi të plote juridike për të vepruar, indentifikuar me nr pasaporte :BR8787802 dhe me numer personal ID H70810052B.

Qendra e Shoqërisë

Neni 2

Selia e Shoqërisë **DAG Construction sh.p.k** ndodhet në adresën Lagjia Xhevdet Nepravishta, rruga Kongresi, ndërtesa me Nr.46, apartamenti 64,Zk =8571,Lushnjë,Fier. Shoqëria ka të drejtë të hapë dege apo filiale në të gjithë vendin.

Kohezgjatja e veprimtarisë ekonomike

Neni 3



Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar.

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë

Neni 4

Objekti I veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

Ndërtime të ndryshme kulturore, turistike, shtetërore, shëndetësore, bujqësore, fabrika, uzina, banesa, komplekse banimi, hotelerie etj. Projektme, instalime, punime restaurimi etj. Veprimtari në fushën e transportit, të mallrave brenda dhe jashtë vendit, me mallrat të vetë shoqërisë dhe të të tretëve. Import-eksport në përgjithësi brenda dhe jashtë vendit. Import-eksport mobilje, veshje MBF, mobilim sallash konferencash, parket, mokat. Ndriçim, import-eksport, ndriçim tavanesh. Veprimtari në fushën e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis dhe auditimin mjedisor, veprimtaritë e lidhura me mbrojtjen kundër zjarrit dhe auditimit të energjisë.Grumbullim dhe transportim të mbetjeve inerte. Ndërtim ujësjellësa, kuz, mbrojtje lumore, diga, etj. Aplikim dhe marrja nga Qeveria Shqiptare apo Institucionet e Shtetit Shqiptar i të gjitha Lejeve, Licencave, Autorizimeve dhe Miratimeve paraprake/perfundimtare, të cilat mundësojnë ndërtimin e objekteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë si dielli, era, uji, etj. si



dhe i veprave të tyre ndihmëse, dhe zhvillimin e këtyre aktiviteteve në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë; Implementimi, menaxhimi i projekteve gjeneruese të energjisë elektrike, të cilat shfrytëzojnë burimet e rinovueshme të energjisë si dielli, era, uji, etj, si dhe i veprave të tyre ndihmëse, si dhe shfrytëzimi operimi dhe mirëmbajtja e tyre; Importi dhe eksporti i mallrave e paisjeve të teknologjive të ndryshme në fushën e energjisë elektrike, që përdoren për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve/sistemeve/impjanteve fotovoltaike, eolike, hidrike (përfshirë panelet diellore, turbinat e erës, inverterat, transformatorët, linjat e transmetimit/shpërndarjes, dhe gjithë aksesoret/pajisjet e tjera të konvertimit, transmetimit, sinjalizimit, monitorimit, mbrojtjes, transmetimit të të dhënave), etj; Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër të nevojshëm apo të dobishëm për realizimin e qëllimeve për të cilat është krijuar, i cili nuk ndalohet me ligj.

Aktivitetet e sipërpërmendura do të realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar në fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, të miratuar nga ortakët e saj.

Shoqëria mund të zgjerohet ose të kufizohet fushën e veprimtarisë së saj në çdo kohë..

Neni 5

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve të asamblese së ortakëve.

Kapitali I shoqërisë

Neni 6

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme që nenkuptohet i përbërë nga 2 (dy) kuota me vlerë të përgjithshme prej 100 000 leke. Këto kuota i përkasin ortakëve si më poshtë

1. Darien Xhindoli zotëruar i kapitalit , 1 (një) kuota me vlerë 50 000 leke, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë..
- 2- Glon Bakalli zotëruar i kapitalit , 1 (një) kuota me vlerë 50 000 leke, që përben 50 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ky kapital mund të shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit të ortakëve.


Drejtimi dhe administrimi

Neni 7

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 8

Ortaku i shoqërisë me krijimin e kësaj shoqërie pjesën e kapitalit të derdhur prej tij nuk mund ta tërheqin. Kjo mund të bëhet vetëm pasi të nxirret bilanci I shoqërisë për fitimin e realizuar.



Neni 9

Emertimi I shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve si dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

Neni 10

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

Kompetencat e ortakeve

Neni 11

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, ortaku shprehet me vendime per gjithshka qe eshte ne kompetencat e tij te pershkruara si me poshte:

Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.

Kane te drejte te miratojne bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.

Ata emerojne administratoren, zevendesit, ekspertet dhe revizoret kontabel.

Ata aprovojne cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencat e tyre

Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit

Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.

Bejne transferimin e kuotave te te tretet

Bejne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shtetore per pjesmarrjen ne tender ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme

Realizojne blerje, shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise.

Kane te drejte te bejne modifikimin e kontrates se shoqerise, etj.

Neni 12

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Administrimi

Neni 13



Administrator i shoqerise eshte Darien Xhindoli, shtetas shqiptar, i datelindjes 20.07.1979, lindur ne Lushnje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, indetifikuar me nr leternjoftim : 033367435 dhe me numer personal ID H90720230J. Afati i mandatit eshte 5 (pese) vjet, duke filluar nga 07.12.2023-06.12.2028.

Neni 14

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administrator te deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje rregullore te brendshme te shoqerise.

Neni 15

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qelimeve te shoqerise duke



perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe Statut qe I takojne ortakeve. Raporti I administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

Marredheniet e punes
Neni 16

Marredheniet e punes regullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit
Neni 17

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori I shoqerise.

Ekspertet ose revizoret kontabel
Neni 18

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise I besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Viti financiar, bilanci vjetor, shperndarja e fitimeve
Neni 19
Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti I pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.


Miratimi I dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 muajve qe nga fundi I vitit financiar.

Bilanci dhe fitimet
Neni 20

Veprimtaria ekonomike do te mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten I kalojne ortakeve te shoqerise.

Neni 21

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.



Shperndarja dhe likuidimi I shoqerise
Neni 22

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

Librat e shoqerise
Neni 23

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve te administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mesiperem duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

Dispozita te pergjitheshme
Neni 24

Per sa esht shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Ligjit 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Statutit dhe regullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

Ortake
Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

Darien Xhindoli



Glon Bakalli

